



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr.104/02-2146/21
Kaçanik: 29.01.2021

Në bazë të nenit 9 pika 1.8 të Udhëzimit Administrativ nr.03/2012 - MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi , Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur më 29 Janar 2021 ,u;

INFORMUA

1.Me aktivitetin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) të zhvilluar në vitin 2020 nga ky këshill, paraqitur në raportin e tij të punës, me tekst të mëtejme “ Raporti i punës së KKSBB- së për vitin 2020”.

2. Në raportin e KKSBB të lartëshënuar, janë cekur të gjitha aktivitetet të cilat i ka realizuar ky këshill në mbledhjet e mbajtura për gjatë vitit 2020, në të cilat takime është diskutuar për situatën e sigurisë në Komunën e Kaçanikut si dhe me rekomandimet të cilat i kanë nxjerrë ky këshill në takimet e mbajtura.

3. Pjesë përbërëse e kësaj shkrese është : Raporti i punës së KKSBB- së për vitin 2020 i përmbledhur në gjithsej 4 faqe/ Lënda: 01Nr. 104/02-2146/21.

Me këtë shkresë njoftohen : Kryetari i Komunës, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi dhe Arkivi.

Kryesues/ Kuvendit
Kemal Mërseli





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data	21.01.2021	Vendi	Kaçanik
Nj. org.	Numri	Shtojcë		
01-104/02-2146/21				

Republika e Kosovës

Komuna e Kaçanikut

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSB)-

01.Nr. zyrtar/ 2021

Raporti i punës së KKSB –së për vitin 2020

Takimi i parë i KKSB për vitin 2020 është mbajtur me **26 shkurt** të këtij viti të cilin e ka udhëhequr Nënkrjetari i i Komunës ndërsa për gjendjen e sigurisë në komunën tonë ka raportuar zv.Komandanti i Stacionit të Policisë i cili raportoi mbi gjendjen e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve si dhe ofroi një njoftim mbi sfidat dhe të arriturat për vitin 2019, ku krahasuar me vitin paraprak(2019) u tha se ka pasur ulje të veprave kriminale.

Nga ky takim janë nxjerrë këto rekomandime:

1. Të përcillen shqetësimet në nivelin qendrorë rreth mungesës së shenjave informuese dhe ndriçimit në kyçe të autostradës në Fushën e Pajtimit,
2. Të organizohen më shumë aktivitete vetdijësuese nëpër shkolla rreth dukurive negative e në veçanti për narkotikët dhe dukurinë e bulizmit,
3. Të organizohen takime më të shpeshta nëpër shkolla me prindër,
4. Të pengohet zhvillimi i veprimtarive të ndryshme biznesore nëpër trotuare.

Takimi i dytë i KKSB është mbajtur më **25.06.2020** që është kryesuar nga Kryetari i Komunës dhe janë diskutuar tema të ndryshme që prekin sigurinë e qytetarëve. Komandanti i Stacionit të Policisë z.Halim Shehu i cili raportoi mbi gjendjen e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve e që sipas tij ka qenë e qetë edhe pse jemi përballur edhe me sfida tjera siç ishte situata me pandemi.

Rreth situatës me pandemi më shumë raportoi Kryetari i Komunës i cili tha se jemi ndër komunat e para që kemi formuar Këshillin emergjent për menaxhimin e pandemisë dhe jemi të kënaqur me punën që kanë bërë anëtarët e këtij këshilli.

Vlen të theksohet se pjesë e këtij Këshilli kanë qenë edhe një pjesë e anëtarëve të KKSB dhe të cilët kanë dhënë kontributin e tyre në menaxhimin e situatës.

Rekomandimet e nxjerra nga ky takim ishin:

1. Të merren masa rreth parandalimit të më tutjeshëm të virusit COVID-19,
2. Të merren masa ndaj portaleve që nxisin urrejtje dhe japin informata të rrejshme,
3. Të ju tërhiqet vërejtje për neglizhencë të punës kompanive që merren me trajtimin e qenve endacak,
4. Institucionet të jenë në gatishmëri të plotë në parandalimin e zjarreve,
5. Të hulumtohet hapësirë për tregun e gjelbër,
6. Të merren masa rigoroze ndaj dëmtuesve të pyjeve,
7. Të rregullohen hidrantë ujore jashtë zonës urbane,
8. Të monitorohet aktiviteti i pishinave,
9. Të bëhet zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik,
10. Angazhim më i madh në parandalimin e dukurisë së vjedhjeve
11. Të jepen informata më të shpejta nga institucionet rreth menaxhimit të situatave të ndryshme,
12. Të merren masa ndaj organizatorëve të aktiviteteve që nuk njoftojnë paraprakisht për aktivitetin e tyre.

Më datë **06.08.2020** është mbajtur takimi i tretë të cilën e kryesoi Kryetari i Komunës dhe pos temës aktuale mbi gjendjen e sigurisë dhe menaxhimi i situatës me pandeminë u trajtuan edhe kërkesat e qytetarëve që janë drejtuar në zyrat e Komunës si dhe kërkesat përmes kutive të ankesave që gjinden nëpër institucione komunale.

Rekomandimet e nxjerra nga ky takim ishin:

1. Mobilizim lokal në përballje me pandeminë COVID-19 në aspektin logjistik dhe fushatë vetdijësuese,
2. Të përcillet lëvizja e personave të infektuar nga virusi COVID-19 e që kanë marrë rekomandim për vet izolim,
3. Të faktorizohen administratorët e lokaliteteve karshi kërkesave të qytetarëve,
4. Të evidentohen të gjitha kërkesat e qytetarëve që kanë të bëjnë me sigurinë publike,
5. Koordinim më i mirë i institucioneve rreth procedurave të varrimit në rastet që kanë të bëjnë me virus COVID-19,
6. Të merren masa ndaj personave që nuk respektojnë ligjet dhe nuk ju përmbahen rregullave të institucioneve në përgjithësi,
7. Të ju jepet vërejtje kompanisë „Pastërtia” në lidhje me menaxhim të dobët në mbledhjen e mbeturinave,

8.Kërkohet bashkëpunim edhe më i mirë në menaxhimin e situatave të ndryshme me të gjithë akterët e sigurisë.

Takimi i katërt me radhë është mbajtur më datë **21.09.2020** kryesuar nga Kryetari i komunës në të cilin takim u diskutua mbi gjendjen e sigurisë në përgjithësi në komunën tonë , situata me pandeminë si dhe i trajtua tema e menaxhimit të mbeturinave. Në këtë takim gjithashtu u formua edhe grupi punues për përpilimin e Planit të Punës të KKS-së, për vitin 2021.

Nga ky takim u nxjerrën këto rekomandime:

- 1.Të merren masa ndaj zyrtarëve të pyjeve që po bashkëpunojnë me dëmtuesit,
- 2.Angazhim maksimal në ruajtjen e shëndetit në përgjithësi,
- 3.Angazhim i përbashkët në parandalimin e dëmtimit të pyjeve,
- 4.Të merren masa ndaj personave që prishin imazhin e mësimdhënësit me sjellje devijonte,
- 5.Të investohet më shumë në ruajtjen e ambientit dhe mjedisit.

Mbledhja e radhës e parafundit për këtë vit është mbajtur më datë **27.10.2020** dhe është kryesuar nga Kryetari i Komunës . Në këtë mbledhje u trajtuan temat aktuale si gjendja e sigurisë në Komunën tonë , situata me pandeminë si dhe përgatitjet për sezonin e dimrit.

Në këtë mbledhje u nxjerrën këto rekomandime:

- 1.Të zbatohen me përpikëri masat ndaj virusit COVID-19,
- 2.Krahas masave ndaj virusit COVID-19 të mos anashkalohen edhe masat ndaj veprave tjera jo ligjore,
- 3.Të zbatohen kriteret e ndërtimit afër rrugëve,
- 4.Një kujdes i shtuar që gjatë ndërtimeve të objekteve afër rrugëve të rregullohen edhe kanalet e ujërave atmosferik,
- 5.Të vendosen dhe të kontrollohen kamerat e sigurisë në çdo vend që është e arsyeshme vendosja e tyre,
- 6.Angazhim edhe më i madh i inspektorëve komunal në parandalimin e çdo veprë jo ligjore.

Mbledhja e fundit e KKS-së për vitin 2020 u mbajtur më datë **10.12.2020** të cilën e kryesoi Kryetari i Komunës dhe u shqyrtuan temat që kanë të bëjnë me situatën e sigurisë në përgjithësi në komunën tonë , menaxhimi i situatës me pandeminë , trajtimi i temës së ekstremizmit të dhunshëm si dhe u miratua Plani i Punës së KKS-së për vitin 2021.

Nga ky takim u nxjerrën këto rekomandime :

1. Të identifikohen pikat kritike në territorin e komunës , që kanë të bëjnë me sigurinë publike dhe të merren masa në sanimin e problemeve që paraqiten në këto pika,
2. Koordinim edhe më i mirë në mes institucioneve qendrore e lokale dhe qytetarëve në lidhje me menaxhimin e pandemisë,
3. Zyrtarët policorë të kenë sjellje më të mira ndaj qytetarëve gjatë kryerjes së detyrave të tyre,
4. Të vazhdohet me aktivitete që e parandalojnë ekstremizmin e dhunshëm.

Monitorues në dy takimet e para të KKSBB-së ishin përfaqësues nga OSBE .

Në muajin prill ka qenë i paraparë edhe një takim por që për shkak të situatës së krijuar me pandeminë COVID-19 ky takim është pamundësuar ngase nga ky muaj nga niveli qendrorë janë ndaluar të mbahen takime të niveleve të tilla dhe gjendja e sigurisë ka kaluar në kompetenca të këshillave emergjente ,por që ky takim është zëvendësuar në muajt në vazhdim të vitit.

Më datë **18.06.2020** në bashkëpunim me organizatën „KosovaPartners” kemi organizuar punëtori dy ditore me temë „Së bashku për të parandaluar dhe luftuar ekstremizmin e dhunshëm në Kosovë”. Kjo punëtori kishte të bëjë me fuqizimin e organizatave të shoqërisë civile në lidhje me këtë fushë .

Pjesëmarrës në këtë punëtori ishin të gjithë akterët e sigurisë në komunën tonë si dhe përfaqësues të shoqërisë civile .

KKSBB ka arritur që të i mbajë të gjitha mbledhjet e planifikuara me plan të punës dhe pos këtyre takimeve anëtarët kanë qenë të angazhuar në menaxhimin e situatës me pandeminë si dhe i kanë raportuar nivelit qendrorë në lidhje me punën KKSBB përmes plotësimit të pyetësorëve të kërkuara nga ata .

Të gjitha takimet e mbajtura të KKSBB gjithashtu janë publikuar në web. faqen e Komunës.

Kaçanik ,më **18.01.2021**

